

# Auditori evidencon mosefikasitet në financa dhe prokurim

Arian Duriqi

LIPJAN, 3 GUSHT – Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013, ka gjetur mosefikasitet dhe një mal problemesh në financat dhe prokurimin e kësaj komune. Në përmblidhjen e përgjithshme raporti ka dhënë detaje për secilin fushëveprim financiar veç e veç, ndërsa më pas edhe konkluzionin e përgjithshëm. Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni i përgjithshëm i Auditorit është se menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrole nuk ishin mjaft efektive në disa fusha kyçe të menaxhimit financiar.

“Në veçanti, ne kemi identifikuar edhe pse pasqyrat vjetore financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për prezantim, pasqyrat vjetore financiare të paraqitura për auditim kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish. Disa janë ndryshuar në versionin final të pasqyrave vjetore financiare, por menaxhmenti zgjodhi t'i linte disa zëra të pakorrigjuar”, thuhet në konkluzionin e raportit në një pjesë të saj. Por aty përmenden edhe rreziqet në këtë plan. “Rreziqet domethënëse që ishin materializuar ishte raportimi i gabuar i pagesave nga palët e tretë në shumën prej 1.588.153 eurosh. Në totalin e këtyre pagesave përfshihen edhe pagesat (bashkëfinancimet) për projekte të ndryshme të kryera nga MAPL, MASHT dhe



Raporti shkruan se niveli i implementimit të rekomandimeve nga viti i mëparshëm është shumë i ulët. Komuna prej 21 rekomandimeve të dhëna kishte adresuar plotësisht vetëm pesë prej tyre, ndërsa kjo ka shkaktuar që disa nga dobësitë të përsëriten, madje në forma edhe më të theksuara

Ministria e Infrastrukturës në vlerë prej 1.162.937 eurosh”, thuhet mes tjerash aty.

Ndërkohë që probleme janë paraqitur edhe në implementim rekomandimesh nga vitet paraqite. Raporti shkruan se niveli i implementimit të rekomandimeve nga viti i mëparshëm është shumë i ulët. Komuna prej 21 rekomandimeve të dhëna kishte

adresuar plotësisht vetëm pesë prej tyre, ndërsa kjo ka shkaktuar që disa nga dobësitë të përsëriten, madje në forma edhe më të theksuara. E probleme ka pasur edhe në Prokurim. Raporti flet për mënyrën se si Prokurimi, gjithashtu, është përcjellë me mangësi serioze. Krahas mangësive në administrimin e procedurave, thuhet se Komuna kishte hyrë në kontrata prej 5.9 mil-

ionë eurosh, duke zotuar vetëm 1.7 milionë euro. Ndërsa, për shkak të dështimeve të kontroleve menaxheriale, në fund të vitit Komuna ka prezantuar obligime të papaguara për paga prej 288.474 eurosh, për shkak të mbetjes së disa punonjësve arsimorë jashtë listës së pagave. Janë identifikuar edhe parregullsi të pagesave të pushimeve të lehonisë. Për të gjitha këto që janë gjetur ka

pasuar edhe rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm. Auditori kërkon që në procesin e hartimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2014 të përfshihet rishikimi nga menaxhmenti i draft-pasqyrave me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme. Po ashtu rekomandime janë dhënë edhe për Prokurim. Është kërkuar një vlerësim i detajuar i procesit të Prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar se pse dobësitë vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i adresuar këto dobësi. Për më tepër, për dobësitë që janë shfaqur në raport dhe rekomandimet e përsëritura nga viti në vit, ka pasur deklaram edhe shoqëria civile në Lipjan. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në OJQ-në YAHR, ka thënë se Komuna në të gjitha nivelet menaxhuese duhet të marrë në konsiderim këshillat dhe rekomandimet e auditimit në mënyrë që të arrihen efektet që po kërkohen. Ndërsa Labinot Shahini këshilltar nga LDK-ja në KK të Lipjanit, ka deklaruar se raporti ka zbardhur keqmenaxhimin e pushtetit të kaluar në financa e prokurim.

“Vetë braktisja e mbledhjes nga këshilltarët e PDK-së në mbledhjen e fundit kur diskutohet për raportin e auditimit të jep të kuptosh se ata kanë ikur nga përgjegjësitë që kanë bartur në periudhën e qeverisjes së tyre për të cilat flet raporti i auditorit”, ka thënë ai.

© KOHA Ditore